



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura VIII  
Sesioni Pranveror  
Kryesia e Kuvendit  
P-058

Prishtinë, më 20 shkurt 2023, ora 11:15  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 20 SHKURT 2023

**Në mbledhje morën pjesë:** Kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, Saranda Bogujevci, Enver Hoxhaj, Kujtim Shala dhe Bekim Arifi, nënkryetarë të Kuvendit.

**Nga grupet parlamentare në mbledhje morën pjesë:** Mimoza Kusari-Lila, Abelard Tahiri, Arben Gashi, Besnik Tahiri dhe Enis Kervan.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:** Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, Ismet Krasniqi, si dhe stafi përgjegjës në mbështetje të Kryesisë së Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit.

Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme të Kryesisë së Kuvendit,
2. Pikat e papërfunduara nga seancat e mëparshme,
3. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
4. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave.

## **1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme të Kryesisë së Kuvendit, të mbajtura më 6 dhe 13 shkurt 2023**

Kryesia i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë së Kuvendit, të mbajtura më 6 dhe 13 shkurt 2023.

## **2. Pikat e papërfunduara nga seancat e mëparshme**

Pas diskutimeve, kryetari me konsensus vendosi për vazhdimin e dy (2) seancave plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, që të mbahet të mërkurën, më 22 shkurt 2023, në orën 12:00, me këtë:

Rend dite

### **I. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 23 dhjetor 2022:**

4. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-198 për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë për Programin e Financave Publike dhe Rritjes Ekonomike ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar,*
5. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-162 për ratifikimin e Marrëveshjes së financimit ndërmjet të Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për “Projektin e reformës së sistemit të ndihmës sociale në Kosovë”*
6. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-203 për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë për Projektin - korniza e qyteteve të gjelbra 2 dritarja 2 - eficiency e energjisë në ndërtesa publike në Prishtinë, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim,*
7. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-204 për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë për Projektin - eficiency e energjisë në ndërtesa publike në Prizren, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim,*
9. *Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 08/L-152 për antidopingun,*
10. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-072 për bujqësi dhe zhvillim rural,*
11. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-145 për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes,*
12. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-190 për zhvillimin rajonal të balancuar,*
13. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-185 për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore,*
14. *Debat parlamentar në lidhje me Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2022,*
15. *Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës për vitin 2021.*

### **II. Pika e papërfunduar nga seanca e jashtëzakonshme, e mbajtur më 22 dhjetor 2022:**

1. *Votimi i Strategjisë së Energjisë të Republikës së Kosovë për periudhën 2022-2031.*

Ndërsa, nuk u vendos për vazhdimin e seancave tjera, me pikat e papërfunduara.

### **3. Përgatitjet për seancën plenare të radhës**

Kryetari, pas diskutimeve për rendin e ditës të propozuar për seancë plenare, me miratimin e tij me konsensus, vendosi që seanca e re plenare e Kuvendit të Republikës së Kosovës të mbahet të enjten, më 23 shkurt 2023, në orën 10:00, me këtë:

#### *Rend dite*

- 1. Deklarimet jashtë rendit të ditës,*
- 2. Pyetjet parlamentare,*
- 3. Votimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-180 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,*
- 4. Votimi i Projekt-rezolutës për adresimin e çështjes së rritjes së faturave të tatimit në pronë,*
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-215 për ratifikimin e Marrëveshjes për Lëvizjen e Lirë me Letërnjoftime në Ballkanin Perëndimor,*
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-216 për ratifikimin e Marrëveshjes për Njohjen e Kualifikimeve të Arsimit të Lartë në Ballkanin Perëndimor,*
- 7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-217 për ratifikimin e Marrëveshjes për Njohjen e Kualifikimeve Profesionale të Mjekëve, Stomatologëve dhe Arkitektëve në kontekstin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore,*
- 8. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me menaxhimin e krizës energjetike nga Qeveria e Republikës së Kosovës,*
- 9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-208 për parqet industriale dhe teknologjike,*
- 10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-209 për investime të qëndrueshme,*
- 11. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë nr. 04/112, datë 13. 12. 2022 për miratimin e rekomandimit të Komisionit Ndërmimor për Investime Strategjike për dhënien e statusit Investor Strategjik për subjektin investues “Moxico Luma Kosova Mining L.L.C.”,*
- 12. Shqyrtimi i Planit Hapësinor për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”,*
- 13. Shqyrtimi i Propozimit të GP Multietnik për shkarkimin e nënkryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Bekim Arifi.*

### **4. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave**

*1. Shqyrtimi i Projekt-Rregullores për strukturën organizative, klasifikimin e pozitave, shtesat dhe kompensimet mbi pagën bazë të nëpunësve civilë të Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës*

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, Ismet Krasniqi, i njoftoi të pranishmit se ashtu siç ishte kërkuar në mbledhjen e mëparshme nga Kryesia e Kuvendi, Administrata e Kuvendit i ka bërë disa korrigjime dhe ndryshime në Projekt-Rregulloren për strukturën organizative, klasifikimin e pozitave, shtesat dhe kompensimet mbi pagën bazë të nëpunësve civilë të Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Ai po ashtu e prezantoi përmbajtjen e kësaj Projekt-Rregulloreje, si për kategoritë, ashtu edhe për shtesat dhe kompensimet e parapara për nëpunësit e shërbimit civil të Administratës së Kuvendit. Diskutimi i plotë i Sekretarit të Kuvendit, Ismet Krasniqi, është dhënë në transkript.

Më pas, nënkryetarja e Kuvendit, Saranda Bogujevci, kërkoi që të përgatitet një sqarim me shkrim për këtë Projekt-Rregullore dhe t'u shpërndahet Kryesisë së Kuvendit, para se të miratohet. Diskutimi i plotë i nënkryetares znj. Bogujevci është dhënë në transkript.

Pastaj, në lidhje me Projekt-Rregulloren e lartshënuar dhe çështjen e shtruar nga nënkryetarja e Kuvendit, Saranda Bogujevci, diskutoi nënkryetari i Kuvendit, Enver Hoxhaj, diskutimi i të cilit është dhënë në transkript.

Në vazhdim, kryetari i Kuvendit konstatoi se Projekt-Rregullorja do të votohet në mbledhjen e ardhshme të Kryesisë së Kuvendit, e cila do të mbahet më 27 shkurt 2023. Diskutimi i plotë i kryetarit është dhënë në transkript.

## *2. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Stokholm (Suedi)*

Kryetari i njoftoi të pranishmit se në lidhje me kërkesën e lartshënuar është proceduar një ndryshim, përkatësisht që kryetarja e Komisionit për Punë të Jashtme dhe Diasporë, Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, do të udhëtojë në vend të deputetit Haki Abazi. Diskutimi i plotë i kryetarit është dhënë në transkript.

Pastaj, Kryesia, në lidhje me kërkesat e lartshënuara, mori këtë:

### V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, Xhavit Haliti, Mefail Bajqinovci dhe Rashit Qalaj u lejohet udhëtimi zyrtar në Stokholm (Suedi), prej datës 1 deri më 4 mars 2023.
2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit (me tejkalim të shpenzimeve), të pajisjes me vizë dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës
3. *Kërkesa për aprovim paraprak dhe mbulim të shpenzimeve për udhëtimin zyrtar*

Kryesia, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

### P Ë R F U N D I M

1. Kryesia e Kuvendit e lejon në parim udhëtimin zyrtar të një delegacioni katër (4) anëtarësh të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione, i paraparë që të realizohet në njërën nga shtetet evropiane: Gjermani, Belgjikë, Francë, apo ndonjë vend tjetër evropian, i cili planifikohet të realizohet nga data 12 deri më 15 mars 2023.
2. Për shpenzimet e realizimit të udhëtimit zyrtar nga pika një (1) e këtij përfundimi do të vendoset pas parashtrimit të kërkesës për këtë udhëtim zyrtar.

*4. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve të drekës më 3 shkurt 2023*

Kryesia, në lidhje me kërkesat e lartshënuara, mori këtë:

V E N D I M

Mbulohen shpenzimet në shumën prej 668,60 euro, sipas faturës për drekën e punës së Kryesisë së Kuvendit me Administratën e Kuvendit, më 3 shkurt 2023.

*5. Kërkesa e deputetes Mimoza Kusari-Lila për lejimin e udhëtimit zyrtar në Shqipëri*

Kryesia, në lidhje me kërkesat e lartshënuara, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Mimoza Kusari-Lila, i lejohet udhëtimi zyrtar në Tiranë (Shqipëri), prej datës 3 deri më 5 mars 2023.
2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit për të lartshënuarën në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga organizatori, ndërsa mëditjet mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

*6. Kërkesa e deputetes Time Kadrijaj për lejimin e udhëtimit zyrtar në Bullgari*

Kryesia, në lidhje me kërkesat e lartshënuara, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Time Kadrijaj, i lejohet udhëtimi zyrtar në Sofje (Bullgari), prej datës 22 deri më 24 shkurt 2023.
2. Shpenzimet e transportit, të akomodimit dhe ushqimit për të lartshënuarën në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga organizatori, ndërsa mëditjet mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kryetari e mbylli mbledhjen në orën 11:50 minuta.

Glauk Konjufca

---

Kryetar i Kuvendit

*Procesverbalin e hartoi:*

*Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*